



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0672

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) PM GROUP SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi Komunal - Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim me numër të prokurimit 623-25-4730-1-2-1, me 19.09.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishte e bazuar ankesa e OE PM GROUP SH.P.K., me nr. 2025/0672, e datës 21.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim me numër të prokurimit 623-25-4730-1-2-1.

2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kuvendi Komunal - Rahovec, ndërkajsh aktiviteti i prokurimit ‘Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim me numër të prokurimit 623-25-4730-1-2-1..

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Me qenë se ankesa e operatorve ekonomik ankues aprovohen si pjesërisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.05.2025 Kuvendi Komunal – Rahovec., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim me numër të prokurimit 623-25-4730-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 64,940.00 €.

Me 04.07.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë KLER CLEAN; Eko Lan Group Sh.P.K.

Me 09.07.2025, OE PM GROUP SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 11.07.2025.

Me 21.07.2025, OE PM GROUP SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0672, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik PM GROUP SH.P.K., lidhur me ankesën 0672/2025:

Me datë 09.07.2025, PM GROUP SHPK ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr. 623-25-4730-1-2-1, me titull "Furnizimi me material higjieniko– sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim". Kërkesa jonë është refuzuar me vendim të Autoritetit Kontraktues të datës 11.07.2025, me arsyetimin se nuk kemi dorëzuar

Fletë-datën e Sigurisë (SDS) për një produkt të vetëm dhe mungesë të mostrës për një pozicion të caktuar. Në vend që të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë dokumentacioni i dorëzuar nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standarde të ndryshme dhe ka shpërblyer operatorin ekonomik tjetër, KLER CLEAN SHPK – EKO LAN SHPK, i cili ka shkëlur disa nga kërkesat thelbësore të dosjes së tenderit.

Në këtë ankesë, do të paraqesim argumentet dhe bazën ligjore që vërtetojnë padrejtësinë e këtij vendimi dhe do të kërkojmë që të anulohet vendimi për refuzim të kërkesës sonë dhe të bëhet rivlerësim i ofertave sipas dispozitave ligjore dhe specifikimeve të tenderit. Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.07.2025, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim dhe është vazhduar shpërblymi i kontratës në favor të OE-së KLER CLEAN SHPK – EKO LAN SHPK, me arsyetimin se nuk kemi dorëzuar SDS për një produkt dhe

mungon një mostër.

Trajtim i pabarabartë dhe standard i dyfishtë nga Autoriteti Kontraktues

Jemi eliminuar nga procedura e prokurimit për mungesë të Fletë-datës së Sigurisë (SDS) vetëm për një produkt specifik (Cipex), ndërkohë që Operatori Ekonomik i shpërblyer ka ofruar produkte me mospërputhje të qarta midis katalogëve dhe përshkrimeve të çmimeve, si p.sh. Fairy, Emsal, Domestos dhe CIF, të cilat janë deklaruar si prodhime nga kompani tëndryshme lokale (PRKIM, SHINY1, ER-ABI etj.). Kjo bie ndesh me kërkesën në Dëshminë 2 të dosjes së tenderit, e cila obligon paraqitjen e katalogëve apo broshurave origjinale nga prodhuesi për secilin produkt të ofertuar.

Dëshmia 2

a. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek Autoriteti Kontraktues katalogë/broshura nga prodhuesi i këtyre furnizimeve për produktet e ofruara duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike.

Në këtë rast, Operatori Ekonomik i shpërblyer nuk ka ofruar as prodhuesin e saktë, as fotografi të qarta dhe të identifikueshme të produkteve të ofruara, gjë që cenon transparencën dhe besueshmërinë e ofertës. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues ka pohuar se “nuk ka rëndësi prodhuesi”, duke theksuar përputhshmërinë teknike si kriterin kryesor. Një qëndrim i tillë bie ndesh me parimet e përcaktuara në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, që garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim për të gjithë operatorët ekonomikë. Megjithatë, nëse prodhuesi nuk është element i rëndësishëm, shtrohet një pyetje e natyrshme: pse është kërkuar katalog nga prodhuesi dhe pse në përshkrimin e çmimeve është kërkuar të vendoset emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës? Këto kërkesa sugjerojnë se identifikimi i saktë i prodhuesit ka qenë pjesë përbërëse e vlerësimit.

Për më tepër, edhe nëse pranohet që përputhshmëria teknike është vendimtare, mbetet e paqartë: cilin produkt do të ofrojë Operatori Ekonomik i shpërblyer në rast se i jepet kontrata? A do të furnizojë produktet e paraqitura në katalog (p.sh. Fairy, Fresh, Domestos etj.), apo ato të cilat janë shënuar në përshkrimin e çmimeve, të cilat janë krejtësisht të ndryshme me katalog? Kjo mospërputhje midis dokumentacionit të ofertës krijon paqartësi lidhur me atë që realisht do të furnizohet, dhe për pasojë, e vështirëson vlerësimin e drejtë dhe të barabartë të ofertave.

Ofertimi me variante të ndaluara

Në Fletën e Termave dhe të Drejtave (FDT), pika 4.1, është përcaktuar qartë:

“Variante autorizohen: Jo.”

Megjithatë, në ofertën e Operatorit Ekonomik të shpërblyer janë paraqitur produkte të ndryshme të njëjta (p.sh. CIF, Fairy, Domestos, Emsal etj.), por me prodhues të ndryshëm, si ER-ABI për Fairy dhe CIF, PRKIM për Domestos, dhe SHINY1 për Emsal. Kjo përbën ofertim me variante të paautorizuara, që është në kundërshtim me kushtet e tenderit.

Sipas Nenit 29 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, oferta që përmban variante të paautorizuara ose që nuk përputhet me kërkesat teknike duhet të shpallet e papërgjegjshme dhe të refuzohet. Për më tepër, Neni 7 i këtij ligji kërkon trajtim të barabartë dhe garë të ndershme, dhe pranimi i ofertave me variante të ndaluara cenon këtë parim themelor. Gjithashtu, Neni 28

parashikon që produktet e ofruara duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të tenderit, dhe ndryshimi i prodhuesve pa autorizim përbën shkelje të këtij neni.

Prandaj, pranimi i ofertave me variante të ndaluara nga Autoriteti Kontraktues është shkelje e qartë e Ligjit për Prokurimin Publik dhe duhet të rezultojë në shpalljen e ofertës së tillë si të papërgjegjshme.

Mungesa e Fletë-datës së Sigurisë (SDS) nuk është trajtuar me drejtësi dhe proporcionalitet

Autoriteti Kontraktues, në Përgjigjen zyrtarë Nr. 3, ka sqaruar se Fletë-datat e Sigurisë (SDS) kërkohen për të gjitha produktet që klasifikohen si substanca ose përzierje kimike të rrezikshme. Kjo përfshin në mënyrë të qartë produkte si shampoonë, detergjentë, Domestos, Varikin, pastrues dritarësh etj.

Megjithatë, gjatë qasjes në dokumentacionin e Operatorit Ekonomik të shpërblyer, kemi konstatuar se SDS janë dorëzuar vetëm për pozicionin 27 dhe 28 (produkte për insekte), ndërsa për produkte të tjera me përmbajtje kimike të rrezikshme nuk është dorëzuar asnjë SDS – përfshirë shampoonat, dezinfektuesin për tualete (Domestos), Varikinin, Acid HCL dhe të tjera që dihet që kanë përbërje kimike dhe është cekur nga vetë AK në përgjigje që është dhënë para hapjes.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka injoruar këtë mungesë të rëndësishme dhe ka eliminuar vetëm ofertën tonë, duke na penalizuar për mungesën e SDS për një produkt të vetëm.

Kjo tregon qartazi trajtim të pabarabartë dhe shkelje të parimit të proporcionalitetit, në kundërshtim me Nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik: PM GROUP SHPK me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi me material higjieniko-sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim, me Numër të prokurimit: 623-25-4730-1-2-1, Numër i brendshëm: 623-25-015-1-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: 04.07.2025, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 09.07.2025, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimore nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/L-042, Ligjit për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 – Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftojmë se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT). Në pajtim me dosjen e tenderit, konkretisht në seksionin “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, pika 9.1 dhe 9.2 – Kapaciteti teknik dhe profesional, në Kërkesën 2, nën-pika b) është kërkuar qartë:

“Të prezantohet SDS ose MSDS e produkteve.”

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye: Operatori Ekonomik nuk ka përbushur këtë kërkesë 2 për pikën b), pasi nuk ka prezantuar Fletën e Sigurisë (SDS ose MSDS) për produktin Nr. 27, gjë që përbën mospërputhje të drejtpërdrejtë me kërkesat minimale të tenderit.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, për produktin nr. 27 (Cipex) me origjinë nga Kina, OE ka paraqitur vetëm një broshurë/katalog të produktit e cila nuk përmban informacionin e strukturuar, teknik dhe të detajuar që përmban një SDS zyrtare, siç kërkohet në fletën e dosjes së tenderit. Për më tepër, në deklaraten në etiketën e produktit të prezantuar nga OE, specifikohen qartë deklaratat e rrezikut:

H350 – Mund të shkaktojë kancer

H373 – Mund të shkaktojë dëmtime në organet e trupit pas ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur

H304 – Mund të jetë fatal nëse gëlltitet dhe futet në rrugët e frymëmarrjes

Ky produkt paraqet rrezikshmëri shumë të lartë për shëndetin e përdoruesve, mësimdhënësve, nxënësve dhe të popullatës, veçanërisht nëse nuk shoqërohet me udhëzime profesionale, trajnim adekuat dhe masa të sigurisë. Për shkak të mungesës së SDS-së, Autoriteti Kontraktues, bazuar në dokumentacionin e tenderit, ka konstatuar se mungesa e SDS-së si dhe prezantimi i një produkti me rrezik të lartë kancerogjen pa dokumentacionin shoqërues të sigurisë, përbën arsye të bazuar për eliminimin e ofertës së Operatorit Ekonomik si jo përputhëse me kërkesat e dosjes së tenderit.

Foto e marrë nga katalogu i produkteve të prezantuara nga OE; PM Group shpk – Prishtinë

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 4: Operatorët ekonomikë bashkë me ofertë duhen të dorëzojnë mostrat për pozicionet tek Përshkrimi i Çmimeve: 6, 14, 18, 22, 24, 26, 27, 28, 32, 33, 34, 36, 39 dhe 42, në pajtueshmëri me specifikat e materialit në këtë Dosje të Tenderit. Mostrat do të dorëzohen në Zyrën e Prokurimit, 30 minuta para hapjes së ofertave. Me këtë rast do të vepohet konform Nenit 37 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i:

a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe

b. shënohen nga një kod.

Dëshmia 4: Mostrat e kërkuara sipas listës së çmimeve tek përshkrimi i çmimeve të mbyllura në një paketim pa shenja dalluese të Operatorit Ekonomik.

Foto e marrë nga mostrat e prezantuara nga OE; PM Group shpk – Prishtinë

Nga mostrat e dorëzuara, nuk është dorëzuar mostra për produktin Nr. 33 – Kontejner PVC me dy rrota për mbeturina 120 litra.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Lidhur me pretendimin për mospërputhje në trajtimin e produkteve të ofertuesve dhe devijimet në përshkrime:

Së pari, sqarojmë se ju si Operator Ekonomik jeni shpallur të papërgjegjshëm, në përputhje me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 04.07.2025, për shkak se:

Nuk keni dorëzuar mostrat, siç kërkohej në dokumentet e dosjes së tenderit;

Keni ofruar produkte që përmbajnë substanca të kategorizuara si kancerogjene, çka përbën rrezik serioz për shëndetin dhe është në kundërshtim të plotë me kërkesat teknike të dosjes së tenderit.

Gjithashtu, sqarojmë se nuk keni parashtruar asnjë pretendim ndaj letrës standarde për eliminim që ju është dërguar, dhe si e tillë eliminimi juaj ka hyrë në fuqi pa ndonjë kundërshtim brenda afateve ligjore.

Pretendimi juaj se produktet e Operatorit të Rekomanduar për Kontratë devijojnë në përshkrim midis katalogut dhe paramasës është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për shkak se:

Kjo çështje nuk ka qenë kriter për vlerësim apo përzgjedhje të ofertave, por një element dytësor i përshkrimit teknik;

Çdo devijim eventual i natyrës që ju e përshkruani mund të konsiderohet si devijim i vogël, që nuk e cenon apo ndryshon thelbin e aktivitetit të prokurimit, dhe si i tillë nuk është bazë për diskualifikim.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklaratën për përputhshmëri me specifikimin teknik të detyrueshëm për të gjitha produktet e ofruara dhe në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit. Ky është një kriter i domosdoshëm që ju OE ankues nuk e keni përmbushur në tërësi.

Sqarojmë gjithashtu se Autoriteti Kontraktues nuk merret me fabrikën apo vendin e prodhimit, por vlerëson vetëm nëse janë ofruar:

Katalogu i produktit;

Deklarata për përputhje teknike, siç kërkohet në dosjen e tenderit.

Bazuar në sa më sipër, pretendimi juaj konsiderohet i pabazuar dhe pa ndikim në rezultatin përfundimtar të vlerësimit të ofertave.

Lidhur me pretendimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk ka dorëzuar (MSDS/SDS):

Sqarojmë se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar MSDS/SDS për produktet, në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit. Gjithashtu, janë dorëzuar mostrat fizike të produkteve, të cilat janë në përputhje të plotë me të dhënat teknike dhe fletë-data bazat e dorëzuara, duke përmbushur kështu kushtin e domosdoshëm për këtë kategori të prokurimit.

Për rrjedhojë, edhe ky pretendim konsiderohet i pabazuar, mbështetur në provat dhe dokumentacionin e paraqitur në ofertë nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 29.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0672, ndërsa me datë 30.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0672. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE PM GROUP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0672, ka vlerësuar si në vijim:

Përmbledhje mbi ecurinë – rrjedhën e procedurës, me titull të kontratës: Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim dhe numër të prokurimit: 623-25-4730-1-2-1 të zhvilluar nga autoriteti kontraktues - Komuna e Rahovecit.

Njoftimi për kontratë është bërë me datë: 28.05.2025

Hapja e ofertave është bërë me datë: 10.06.2025

Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues është marrë me datë: 04.07.2025, ku është rekomanduar për kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik KLER CLEAN; Eko Lan Group SH.P.K.

Me datë: 09.07.2025 operatori ekonomik PM GROUP SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë autoritetit kontraktues - Komuna e Rahovecit.

Me date: 11.07.2025 Kumuna e Rahovecit ka marrë Vendim lidhur me pretendimet e kërkesës për ri-shqyrtim duke e Refuzuar atë në plotëni.

Pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim operatori ekonomik PM GROUP SH.P.K. me datë: 20.07.2025 parashtron ankesë pranë OSHP-së.

PRETNEDIMI I PARË

Përmbledhje lidhur me pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankues

Operatori ekonomik ankues në ankesën e parashtruar pranë OSHP-së, i ka paraqitur pretendimet e tij, duke sqaruar se autoriteti kontraktues Komuna e Rahovecit nuk i ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë, dhe ka përdorur standarde të dyfishta, lidhur me trajtimin e kërkesës për katalogat - emrat e prodhuesve të kërkuar, dhe emrat e prodhuesve të përshkrimi i çmimit, ku sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk e përmbush kërkesën e autoritetit kontraktues dhe se ne jemi eliminuar vetëm për një pozicion ndërsa operatori ekonomik nuk i plotëson disa pozicione dhe e kanë vlerësuar si të përgjegjshëm, pretendimi i operatorit ekonomik ankues është si në vazhdim;

Citoj:

Jemi eliminuar nga procedura e prokurimit për mungesë të Fletë-datës së Sigurisë (SDS) vetëm për një produkt specifik (Cipex), ndërkohë që Operator Ekonomik i shpërblyer ka ofruar produkte me mospërputhje të qarta midis katalogëve dhe përshkrimeve të çmimeve, si p.sh. Fairy, Emsal, Domestos dhe CIF, të cilat janë deklaruar si prodhime nga kompani të ndryshme lokale (PRKIM, SHINY1, ER-ABI etj etj). Kjo bie ndesh me kërkesën në Dëshminë 2 të dosjes së tenderit, e cila obligon paraqitjen e katalogëve apo broshurave origjinale nga prodhuesi për secilin produkt të ofertuar.

Kërkesa e autoritetit kontraktues:

Operatori ekonomik ankues, në pretendimin e tij konsideron se pozicioni numër: 1,2 7 dhe 37, nuk janë të njëjtë emrat e prodhuesve, vendi i origjinës (prodhuesit) të specifikuar në listën e çmimeve dhe kërkesën e autoritetit kontraktues në raport me emrat e prodhuesve të paraqitur në katalog.

Në vazhdim gjeni sqarimet dhe dëshmitë e ofruara, për secilin pozicion të paraqitur nga operatori ekonomik ankues:

Pozicioni numër; 1

Përshkrimi i produktit sipas përshkrimit të çmimit të autoritetit kontraktues:

Detergjent për enë 1 L- Fairy ose ekuivalent.

Për pozicionin numër: 1, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, në katalog ka ofruar emrin e produktit fairy, i cili mund të shihet edhe në dëshminë e prezantuar në vazhdim:

Në tabelën e përshkrimit të çmimit të kërkesës e autoritetit kontraktues është vendosur emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës (PMR INXHINERING – PRKIM, LIPJAN, KOSOVË)

Bashkangjitur gjeni dëshminë:

Pozicioni numër; 2

Përshkrimi i produktit sipas përshkrimit të çmimit të autoritetit kontraktues:

Detergjent pastrues për parket dhe limaninat 1L.

Operatori i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me emrin e prodhuesit EMSAL siç mund të shihni edhe dëshminë si në vazhdim:

Ndërsa te përshkrimi i çmimit është ofruar emri i prodhuesit dhe vendi i origjinës (SHINY 1 SHPK PRIZEREN, KOSOVË)

Shih dëshminë në vazhdim:

Pozicioni numër; 7

Përshkrimi i produktit sipas përshkrimit të çmimit të autoritetit kontraktues:

Domestos 750 ml 24 H ose ekuivalent : përbërsit hipoklorit natrium – dezinfektues (< 5 %) zbardhues me bazë klori (hipoklorit natriumi), (< 5 %) surfakant jo-jonik, (< 5 %) surfakant kationik (< 5 %) sapun aromë.

Në katalogun e ofruar për pozicionin numër 7 ka ofertuar me domestos.

Shih dëshminë në vazhdim:

Ndërsa te kërkesa te përshkrimi i çmimit ka ofertuar me (SHINY1 SHPK PRIZEREN, KOSOVË)

Pozicioni numër; 37

Përshkrimi i produktit sipas përshkrimit të çmimit të autoritetit kontraktues:

Vim te lenget Cif ose ekuivalent .Njesia min 400 ml – Ekuivalente

Te katalogu i ofruar nga operatori ekonomik ka ofertuar me CIF shih dëshminë si në vazhdim:

Ndërsa te përshkrimi i çmimit ka ofertuar si emër të prodhuesit dhe vend të origjinës me (ER-ABI, PRIZEREN, KOSOVË).

Shih dëshminë në vazhdim:

PËRGJIGJJE NË PRETENDIMIN E PARË

Në bazë të arsyeve të dhëna më lartë sqaroj se emrat e prodhuesve të ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk janë në përputhje me emrat e ofruar në katalog me ata të ofruar te përshkrimi i çmimit, ku nuk kanë përmbajtje të njëjtë, poashtu edhe vendet e origjinës së prodhimit (gjatë hulumtimit në internet) nuk janë të njëjtë për prodhuesit e ofruar.

Kërkesat e autoritetit kontraktues kanë për qëllim ofrimin dhe definimin e cilësisë së produkteve dhe për të marrë saktësinë e se me cilat produkte do të furnizohet me rastin e implementimit të kontratës, në rastin konkret, mbi bazën e dëshmive të ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, në mes të katalogut dhe kërkesës te përshkrimi i çmimit nuk mundet të jenë në pajtim me kërkesën e autoritetit kontraktues.

PRETENDIMI I PARË I OPERATORIT EKONOMIK ANKUES ËSHTË I BAZUAR

PRETNEDIMI I DYTË

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se autoriteti kontratkues nuk e ka lejuar në kriteret e dosjes së tenderit dhe në njoftimin për kontratë se nuk lejohen variantet, ky pretendim ndërlidhet me pretendimin e parë, nëse pretendimi i parë konstatohet se operatori ekonomik i rekoanduar për kontratë ka ofertuar me variante atëherë pretendimi i dytë mund të jetë i bazuar pasi që autoriteti kontratkues në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit nuk ka lejuar variante, kështu që pretendimi i dytë ka varësi të plotë nga pretendimi i parë varësishtë se si konstatohet.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN E DYTË

Pasi që pretendimin e parë e vlerësoj si të bazuar, verësoj se për shkak të ndërlidhshmërisë që e ka pretendimi i dytë me të parin, edhe pretendimi i dytë është i bazuar.

PRETENDIMI I DYTË I OPERATORIT EKONOMIK ANKUES ËSHTË I BAZUAR

PRETNEDIMI I TRETË

Operatori ekonomik ankues, në pretendimin e tij të tretë sqaron se autoriteti kontraktues në vlerësimin e tij nuk e ka trajtuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë lidhur me përmbajtjen kimike të rrezikshme duke ofruar operatorët ekonomik SDS ose MSDS.

Citoj;

Pasi që operatori i rekomanduar për kontratë për pozicionet egjithatë, gjatë qasjes në dokumentacionin e Operatorit Ekonomik të shpërblyer, kemi konstatuar se SDS janë dorëzuar vetëm për pozicionin 27 dhe 28 (produkte për insekte), ndërsa për produkte të tjera me përmbajtje kimike të rrezikshme nuk është dorëzuar asnjë SDS – përfshirë shamponat, Dezinfektuesin për toaleta(domestos) , Varikinin , Acid HCL dhe të tjera që dihet që kanë produkte kimike dhe është cekur nga vet Ak në përgjigje që është dhënë para hapjes.

Me datë: 03.06.2025 njëri nga operatorët ekonomik të interesuar ka bërë pyetje sqaruese lidhur me SDS ose MSDS, dhe autoriteti kontraktues i' u është përgjigjur sin ë vazhdim:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues, lidhur me pozicionet se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk i ka dorëzuar SDS ose MSDS për disa pozicione të cilat ai i konsideron se kanë kimikate dhe paraqesin rrezikshmëri.

Në sqarimin e dhënë nga autoriteti kontratkues, duke lënë në diskrecion të operatorëve ekonomik për ti vlerësuar dhe konstatuar se cilat pozicione kanë përbërës kimik dhe paraqesin rrezik, paraqet pasiguri teknike - profesionale dhe i lënë hapsirë, për ankesë dhe kundërankesë të gjithë operatorëve ekonomik pjesëmarrës, pasi që për njërin operator ekonomik mund të jetë një pozicion që paraqet rrezik dhe ka përbërës kimik, derisa tjetri operator ekonomik mund të deklaroj se pozicioni i njëjtë nuk mund të paraqes rrezikë.

Konstatimi i pozicioneve me përbërës kimik dhe rrezikshmëri, është dashur të konkretizohen nga autoriteti kontraktues, në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pasi që kjo situatë mund ti lejë hapsirë operatorëve ekonomik për kontestime të vazhdueshme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN E TRETË

Referuar sqarimeve të dhëna në pretendimin e tretë, kërkesës për sqarime të njërit operator ekonomik të interesuar në fazën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe përgjigjes së dhënë nga autoriteti kontraktues vlerësoj se pretendimi i tretë i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

PRETENDIMI I TRETË I OPERATORIT EKONOMIK ANKUES ËSHTË PJESËRISHTË I BAZUAR

PËRMBLEDHJE

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit, nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Poashtu në pretendimin e tretë gjatë përgjigjeve në sqarimet shtesë, nuk ka ofruar informacion dhe sqarim për të qartësuar kërkesën e operatorit ekonomik njëkohësisht edhe kërkesën e vetë të autoritetit kontraktues.

Mbi bazën e arsyeve të dhëna, duke ju ofruar dëshmi, informacion dhe sqarime në këtë raport të ekspertizës, vlerësoj se ankesa e operatorit ekonomik ankues është e bazuar, andaj të anulohet Njoftimi i Vendimit të autoritetit kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Gjatë rivlerësimit autoriteti kontraktues ti përmbahet, Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, dhe nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara për faktin se OE ankues nuk ka mbrojtur eliminim e tij përderisa është eliminuar nga AK-ja në mungesë të mostrës për çka edhe është kërkuar në NJK dhe DT “ *Kërkesa 4 Operatoret ekonomik bashkë me ofertë duhen të dorëzojnë mostrat për pozicionet tek Përshkrimi i Çmimeve 6, 14, 18, 22, 24, 26, Dëshmia 4 Mostrat e kërkuara sipas listës së çmimeve tek përshkrimi i çmimeve të mbyllura në një paketim pa shenja dalluese të Operatori B05 Njoftim per Kontrat 6 / 8 27, 28, 32, 33, 34, 36, 39 dhe 42, në pajtueshmëri me specifikat e materialit në këtë Dosje të Tenderit*”. Poshtu lidhur me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar ka ofruar variante PSH konsideron se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se në listën e çmimeve përveq produktit me emërtim AK -ja ka kërkuar edhe ekuivalent , ndërsa sa i përket origjinës pavarësisht saktësisë së prodhuesit , mostrat e dorëzuara të cilat përcaktojnë edhe OE-te që do të ofrojnë furnizime për çka kjo kërkesë qëllimin e ka që konform mostrave të bëhet furnizimi në rastë se rekomandohet për dhënje të kontratës një OE , sikurse në këtë procedurë dhe në mostra janë të etikuar se nga janë përfshirë edhe distributorin e autorizuar përfshirë edhe përmbajtjen e artikullit si shembull : Fairy-ekuivalent siq është kërkuar në Listën e çmimeve , dhe ofruar nga OE -ja i rekomanduar , poashtu në ankesën e OE ankues pranë OSHP-së e as në Kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së sikurse kërkohet në nenin 108/A të LPP-së , OE nuk ka aritur të ofroj provë -dëshmi për çka është eliminuar lidhur me

mos prezantimin e Fletën e Sigurisë (SDS ose MSDS), dhe në munges të mostrës nr 33 për çka është kërkuar nga AK, PSH në kuptim të nenit 4 par 1.26 të LPP-së, OE ankues nuk ka aritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur pjesërishtë besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues, por jo edhe rekomandimin që lënda të kthehet ne rivlersim.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e Komunës së Rahovecit – Ritenderim me numër të prokurimit 623-25-4730-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - PM GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: